REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery | 03.06.2021 | | viti god year |
|---|---|---|---|
| Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKMSHC | 2848/2021 | | 1/3 |

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova – Republic of Kosovo

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
### NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
### INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

**A.nr.420/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 2416/2021 të datës 17.05.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rr "Skenderbeu" Suharekë , kundër organit të punësimit- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.06.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e palejuar** ankesa me numër A.nr.420/2021 e datës 17.05.2021, e parashtruar nga ankuesi

## A r s y e t i m

Ankuesi i caktuar në pozitën Zyrtar për drejtime teknike në DAAP në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, i cili sipas Vendimit me nr.2-185 të datës 24.01.2017është transferuar nga pozita Zyrtar për drejtime teknike në DAAP në MASHT në pozitën Inspektor i Arsimit në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Prizren me koeficient 7 sipas Akt emërimit të datës 24.01.2017 ndërsa me vendimin e datës 25.01.2019 Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të punës nënshkruan akt emërimin me koeficient 8 për z.

Me datën 06.03.2018 përmes shkresës me nr.ref.10/84 Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit i është drejtuar Drejtorit të DASHC-me kërkesë për lëvizje të koeficientit nga shtatë (7) në koeficientin tetë(8) për z.

Kërkesën e fundit për harmonizim të koeficientit të inspektorëve të arsimit në DASHC/MAP Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit e ka parashtruar me datën 28.08.2020, ndërsa

ankuesi me datën 17.05.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 2416/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë /Inspektoratit të Arsimit. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë /Inspektorati i Arsimit me datë 27.05.2021 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës faqe 1/24.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2416/2021 të datës 17.05.2021 e parashtruar nga ankuesi përmes e-mailit zyrtar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 25.01.2019 me nr.ref.10.nr.098; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 20.05.2021 me nr. protokolli 2509; Kërkesë për dhënie pëlqimi të ndërrimit –transferit të vendit të punës e datës 20.01.2017; Pëlqim për lejimin e ndërrimit të vendit të punës së z. nga DAAP në SIA Prizren i datës 20.01.2017; Kërkesë për nxjerrjen e vendimit për transfer të përhershëm të nga zyrtar për drejtime teknike –DAAP në Inspektor i Arsimit në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Prizren i datës 23.01.2017; Vendim për transfer i datës 24.01.2017 i Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT; Akt emërimi i datës 24.01.2017; Kërkesë e parashtruar në MAP për lëvizje të koeficientit nga shtatë (7) në koeficientin tetë(8) për inspektoratin e Arsimit në SIA Prizren , z. Vendim i datës 25.01.2019 me nr.ref.10. Nr.097 për harmonizimin të koeficientit i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit; Kërkesë e datës 07.03.2019 për harmonizimin e koeficientit për inspektor i arsimit në Sektorin në Prizren; Kërkesë e datës 01.04.2019 për harmonizimin e koeficientit për të gjithë inspektorët e arsimit; Kërkesë e datës 22.01.2020 për nivelizim të pagës e parashtruar në DASHC/MAP; Kërkesë e datës 28.08.2020 për nivelizimin e pagës të inspektorëve të arsimit e parashtruar në DASHC/MAP dhe Përgjigje në ankesë e datës 27.05.2021 me nr. protokolli 2669/2021 faqe 1/24.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e jashtë afatshme/palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi sipas Vendimit me nr.2-185 të datës 24.01.2017 është transferuar nga pozita Zyrtar për drejtime teknike në DAAP në MASHT është transferuar në pozitën Inspektor i Arsimit në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Prizren me koeficient 7 sipas akt emërimit të datës 24.01.2017. Me datën 25.01.2019 Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit me datën 25.01.2019 nxjerr vendimin për harmonizimin e e koeficientit nga 7 në 8 , dhe me datë 25.01.2019 në akt emërim i ngritët koeficienti në tetë. Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit me datën 07.03.2019 ka parashtruar kërkesë në DASHC/MAP për harmonizim të koeficientit për z. ndërsa me datën 01.04.2019 po i njëjti ka parashtruar kërkesën në DASHC/MAP për harmonizimin e koeficientit për të gjithë inspektorët e arsimit. Kërkesën e fundit Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit në DASHC/MAP për harmonizimin e pagës së Inspektorit të Arsimit z. e ka parashtruar me datën 28.08.2020, ndërsa ankuesi me datën 17.05.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 2416/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020 si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vlerëson se çdo nëpunës civil ka të drejtën të paraqesë ankesë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, me të cilin pretendon se i janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 127 ka përcaktuar se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimin nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**Lënda,A.nr.420/2021,datë 03/06/2021**

**Sabile AVDYLI** — **Arben MEHMETI**

Sabile Avdyli

**Procesmbajtëse** — **Kryetar i Kolegjit**

REPUBLIKA KOSOVA · NEZAVISNI NADZORNI ODBOR ZA CIVILNE SLUŽBE KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO · REPUBLIKA E KOSOVËS

**Vendimi i dorëzohet**:

- Ankuesit
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit /MASHT;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Inspektoratit të Arsimit /MASHT dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*